



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
NJËSIA E PROKURIMIT

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “IMPLEMENTIMI I PLATFORMËS DIXHITALE PËR  
TRAJTIMIN E ANKESAVE TË KONSUMATORËVE”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
72212610-8; 72212983-3**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 8,333,300 lekë (tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind  
lekë) pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Enti Rregullator i Energjisë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 vlerën 166,666 lekë (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë);*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin Vërtetim nga Drejtoria Tatimore për xhiron e realizuar

gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025). Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros për të paktën në një nga tre vitet e fundit financiar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 77, pika 3, e LPP , nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri i shërben AK për të vërtetuar se operatori ekonomik i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën objekt të prokurimit si dhe për t’u njohur me gjendjen ekonomike të OE për tre vitet e fundit.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Dëshmi për përvoja të mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës (fondit limit),**

- Kur përvoja e mëparshme është realizuar me ente publike, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Vërtetim/e të lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose / dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Kur përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur faturën/faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku janë shënuar datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe pikës 4/b të nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata shërbimi, çka rrit besueshmërinë të Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST dhe dispozitat e kontratës.

**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 4 (katër) punonjës, të cilët aktualisht duhet të kenë një marrëdhënie pune me operatorin ekonomik prej jo më pak se 2 (dy) muaj. Punonjësit duhet të jenë të diplomuar në një nga fushat e Teknologjisë së Informacionit, të kualifikuar me njohuri si mëposhtë, të cilët në mënyrë të kombinuar, përmbushin kërkesat për certifikim profesional të bazuar në testim:

- 1 (një) punonjës të certifikuar si ekspert i bazës së të dhënave SQL ose ekuivalente.
- 2 (dy) zhvillues të certifikuar në nivel profesionist në të njëjtën gjuhë programimi si VMware Spring Professional 2023/ Java SE 11 ose ekuivalente.

- 1 (një) punonjës për sigurinë e sistemeve të informacionit i/e certifikuar si Certified Information Security Manager (CISM)/ Certified Information Systems Security Professional (CISSP) ose ekuivalent.
- 1 (një) punonjës të certifikuar si testues softueri.

**Shënim:** Një punonjës mund të disponojë një ose më shumë certifikime.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomat e arsimit të lartë në një nga fushat e Teknologjisë së Informacionit. *Diplomat të përfituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes dhe njësimit zyrtar të Republikës së Shqipërisë.*
- Certifikata/Dëshmi e vlefshme për çdo punonjës të kualifikuar, të lëshuara nga organe/trupa të akredituara në Republikën e Shqipërisë ose në vendin e tyre të origjinës dhe jo nga faqe web-i (site) online, të pa akredituara.
- Formularët E-sig të Listëpagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, për 2 (dy) muajt e fundit, të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të jenë të deklaruar punonjësit e sipërmendur (kriter i përmbushur nëpërmjet plotësimit së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10.)

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë, personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës, duke garantuar dhe kryerjen e një shërbimi cilësor nga ana e tyre.

Kërkesa e AK për 4 (katër) punonjës është vendosur duke pasur parasysh që ky numër punonjës është mëse i nevojshëm për implemetimin dhe zhvillimin e Platformës, duke qenë se ky projekt kalon në disa faza të ndyshme.

Çdo fazë e projektit për të vënë në zbatim, zhvilluar, trajnuar dhe mirëmbajtur Platformën dixhitale, kërkon punonjës me kualifikimin dhe certifikimin përkatës:

- Kriteri “1 (një) punonjës të certifikuar si ekspert i bazës së të dhënave SQL ose ekuivalente, është kërkuar sepse ky punonjës bën administrimin, strukturimin dhe optimizimin e bazës së të dhënave, duke garantuar integritetin dhe funksionimin e shpejtë e pa bllokime të të dhënave.
- Kriteri “2 (dy) zhvillues të certifikuar në nivel profesionist në të njëjtën gjuhë programimi si VMware Spring Professional 2023/ Java SE 11 ose ekuivalente.”, është kërkuar sepse këta punonjës bëjnë implementin teknik të platformës duke shkruar kodin sipas standarteve të programimit dhe arkitekturës së platformës. Janë kërkuar 2 zhvillues sepse është parashikuar që platforma të implementohet për një afat 4 mujor, dhe për realizimin e saj në kohë, nevojiten 2 punonjës për ndarjen e volumit të punës midis tyre.
- Kriteri “1 (një) punonjës për sigurinë e sistemeve të informacionit i/e certifikuar si Certified Information Security Manager (CISM)/ Certified Information Systems Security Professional

(CISSP) ose ekuivalent”, është kërkuar duke qenë se ky punonjës është i nevojshëm për zhvillimin e masave për sigurinë e informacionit sipas legjislationit në fuqi, dhe mbrojtjen e platformës nga sulmet kibernetike, duke parandaluar kështu rrjedhjen e informacionit.

- Kriteri “1 (një) punonjës të certifikuar si testues softueri” është kërkuar me qëllim që ky punonjës të verifikojë të gjithë funksionalitetin e platformës përpara publikimit të saj, duke garantuar që çdo ndryshim apo përditësim të jetë i qëndrueshëm dhe të mos shkaktojë ndërprerje të platformës.

Kriteri për paraqitjen e diplomave dhe certifikimeve të punonjësve i provon AK që OE ka në stafin e tij punonjës të kualifikuar e të certifikuar sipas nevojave të AK dhe natyrës së këtij projekti .

**2.3.3.** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

**a) Standardin ISO 9001** ose ekuivalent (i përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme)

**b) Standardin ISO 27001** ose ekuivalent (i përditësuar), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme).

**c) Standardin ISO 20000-1** ose ekuivalent (i përditësuar), për sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

**Standarti ISO 9001** ose ekuivalent (i përditësuar) i shërben AK për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjëndje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese. Përbushja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve objekt prokurimi. Ky lloj certifikimi garanton AK se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimeve e ofruara dhe zbatimin e kontratës sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

**Standarti ISO 27001** ose ekuivalent (i përditësuar), i shërben AK për të provuar se operatori ekonomik përbush konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, dhe se OE ka ndërmarrë masat e duhura për të vënë në zbatim një sistem për menaxhimin e risqeve që lidhen me sigurinë e të dhënave.

**Standardi ISO 20000-1** ose ekuivalent (i përditësuar), i shërben AK për të provuar se OE ka certifikimin e duhur për të garantuar mirëmbajtjen, optimizimin e platformës dhe sigurimin e funksionimit të vazhdueshëm të platformës pa ndërprerje .

## **II. Argumentimi i Termave të Referencës**

Termt e Referencës së procedurës së prokurimit janë hartuar nga struktura përkatëse në ERE, duke pasur paraysh nevojën aktuale të Entit Rregulator të Energjisë për të implementuar dhe vënë në funksionim një Platformë për dixhitalizimin e trajtimit të ankesave të konsumatorëve.

Mungesa aktuale në ERE e një platforme të centralizuar dhe funksionale krijon vështirësi në standardizimin e të dhënave, rrit riskun e pasaktësive ose vonesave në përditësim, kufizon gjurmueshmërinë e praktikave dhe e bën më të ngarkuar procesin e raportimit, kontrollit dhe analizës institucionale.

Për këto arsye, lind nevoja për strukturimin, standardizimin dhe dixhitalizimin e mëtejshëm të procesit të administrimit të ankesave dhe kërkesave, me qëllim krijimin e një sistemi elektronik të mirëfilltë, i cili mundëson gjurmueshmëri të plotë, kontroll më të lartë institucional, analizë të strukturuar të problematikave dhe raportim të automatizuar e të besueshëm.

Mbi bazën e këtyre kërkesave dhe nevojave reale për krijimin, zhvillimin dhe mirëfunksionimin e platformës, janë hartuar dhe termtat përkatëse të referencës.

**Përlllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit** është bërë në zbatim të nenit 78 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku ”Komisioni i Testimit të Tregut dhe i Përlllogaritjes së fondit limit”, i ngritur me Urdhër të Kryetarit të ERE, ka marrë oferta nga 3 (tre) operatorë ekonomikë që veprojnë në treg në fushën objekt të procedurës së prokurimit, dhe nga mesatarja e vlerave të ofertave të paraqitura është përcaktuar vlera e fondit limit të kësaj procedure.

### **Njësia e Prokurimit**